



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Nr. 52/1 Prot

Tiranë më 6 . 1 . 2021

Lënda : Relacion sqarues mbi realizimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2020

TIRANË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në mbështetje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Ju dërgon realizimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2020.

Fondet limit në Regjistrin e Realizimeve të Prokurimeve Publike janë pasqyruar për vlerat pa tvsh.

I. Realizimi i Regjistrit për grupin e shpenzimeve në zërin investime (231)

Gjithsej fondi i planifikuar i investimeve për vitin 2020, është 1,666,667 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, të miratuar si produkte nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me objekt "*Blerje Pajisje Elektronike*" me fond limit 1,166,667 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh dhe "*Orendi Zyre të Blera*" me fond limit 500,000 (pesëqind mijë) lekë pa tvsh, të cilat u prokuruan në mbështetje të Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për periudhën respektive.

1. Fondi i planifikuar i investimit i miratuar si produkt nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me objekt "*Blerje Pajisje Elektronike*" me fond limit 1,166,667 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh është prokuruar me procedurën kërkesë për propozim dhe është fituar nga shoqëria "*BNT ELECTRONICS*" Shpk, në vlerën 1,059,600 (një milion e pesëdhjetë e nëntëmijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh ose 91% të fondit të planifikuar. Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar,

si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, likujdimi është kryer në zbatim të kontratës dypalëshe nr.2592 prot, datë 18.8.2020.

2. Fondi i investimeve i miratuar si produkt nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me objekt "Orendi Zyre të Blera", me fond limit 500,000 (pesëqind mijë) lekë pa tvsh është prokuruar me procedurën blerje me Vlerë të Vogël dhe është fituar nga shoqëria "Xhezmi Sigeca" Shpk, në vlerën 396,000 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh ose 79.2% të fondit të planifikuar. Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, likujdimi është kryer pas marrjes në dorëzim të furnizimeve, orendi zyre, sipas sasisë dhe specifikimeve teknike në ftesën për ofertë.

II . Realizimi i Regjistrit për grupin e shpenzimeve në zërin operative (602)

Realizimi i Regjistrit të Prokurimeve për grupin e shpenzimeve operative për vitin 2020, është gjithsej në shumën 69,813,891 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa tvsh ose 96 % e fondit të planifikuar pa tvsh, i cili është prokuruar në zbatim të dispozitat ligjore në fuqi si më poshtë vijon:

1. Shërbimi i ruajtjes me roje civile është vazhdim i Marrëveshjes Kuadër me operatorin ekonomik fitues "Trezhnjeva" sh.p.k. me objekt "Shërbimi i ruajtjes me roje civile" për godinën e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj, nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes kuadër me nr. 2951/1 prot, datë 3.5.2019. Është likujduar marrëveshja kuadër në përputhje me parashikimet ligjore në vlerë 1,273,567.92 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë me tvsh.
2. Fondi i parashikuar për grup artikullin "Blerje materiale kancelarie", me fond limit për 666,667 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, është realizuar me procedurën e blerjes me Vlerë të Vogël dhe është fituar nga operatori ekonomik "Infosoft Office" sh.p.k në vlerën 629,100 (gjashtëqind e njëzetë e nëntë mijë e njëqind) lekë pa tvsh ose 94% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konform specifikimeve teknike të kërkuara.
3. Fondi i parashikuar për grup artikullin "Blerje materiale pastrimi", me fond limit për 416,667 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, është realizuar me procedurën e blerjes me Vlerë të Vogël dhe është fituar nga operatori ekonomik "XH-N-SH GROUP" sh.p.k në vlerën 315,000 (treqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa tvsh ose 76% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konform specifikimeve teknike të kërkuara.

4. Fondi i parashikuar për grup artikullin "*Mirëmbajtje dhe shërbime software (sistemi HIDAACI)*" u prokurua gjatë muajit Shkurt 2020 me procedurën e prokurimit "Tender i Hapur", me fond limit 66,666,667 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, me numër reference të procedurës/lotit REF-51984-02-28-2020. Në zbatim të Aktin Normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19*", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.3.2020 "*Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore*" pika 6, Vendimit të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile nr.1, datë 25.3.2020 "*Për konfirmimin dhe vijimin e zbatimit të masave të veçanta administrative të marra gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19*" dhe Njoftimit nr. 2371 prot, datë 31.3.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, kjo procedurë u pezullua. Me shfuqizimin e pezullimit të procedurave të prokurimit nga APP, procedura është hapur më 2.9.2020. Pas procesit të vlerësimit dhe zbatimit të afateve ligjore, fitues janë bashkimi i operatorëve ekonomikë "IkubINFO"sh.p.k &"Infosoft Systems" sh.p.k , në shumën 64,666,670 (gjashtëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh ose 97% e fondit të planifikuar. U lidh kontrata me BOE "IkubINFO" sh.p.k & "Infosoft Systems" sh.p.k me nr.2968 prot datë 2.11.2020, me afat zbatimi 48 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Likujdimi është periodik mujor sipas përcaktimeve në kontratën e nënshkruar midis palëve.
5. Fondi i parashikuar për grup artikullin "*Shërbim riparim/mirëmbajtje për 3 automjetet e ILDKPKI*", me fond limit 500,000 (pesëqind mijë) lekë, pa tvsh, është realizuar me procedurën e blerjes me Vlerë të Vogël dhe është fituar nga shoqëria "*Servis –Auto 2000*" sh.p.k në vlerën 443,650 (katërqind e dyzet e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh ose 88,7% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara.
6. Fondi i parashikuar për grup artikullin "*Blerje Karburant*", me fond limit për 666,667 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh është realizuar me procedurën e blerjes me Vlerë të Vogël dhe është fituar nga shoqëria "*Gega Center GKG*" sh.p.k në vlerën 560,029 (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëzet e nëntë) lekë pa tvsh ose 84% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara dhe kushteve të përcaktuara në kontratën dypalëshe nr. 2546 Prot., datë 3.8.2020.
7. Fondi i parashikuar për grup artikullin "*Blerje tonera për printera dhe fotokopje*", me fond limit për 1,250,000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh është realizuar me procedurën e prokurimit "*Kërkesë për Propozim*" dhe është fituar nga operatori ekonomik, shoqëria "*Infosoft Office*" sh.p.k në vlerën 841,917 (tetëqind e dyzet e një mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 67.4% e fondit të planifikuar. Likujdimi është

kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara dhe kushteve të përcaktuara në kontratën dypalëshe nr.3201 prot, datë 16.12.2020.


Gjatë kësaj periudhe janë realizuar në përmbushjen e detyrimeve me shtetin si posta, energji, ujë, telefoni. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë lidhur kontrata shërbimi i abonimit në shtyp, siguracione të detyrueshme për automjetet e ILDKPKI, sigurimi i ndërtesës të ILDKPKI, kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes së ashensorit, larjes së automjeteve, është kryer shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparime të pajisjeve teknike të zyrave, të cilat janë realizuar si procedura prokurimi blerje me Vlerë të Vogël.

Përsa i përket shpenzimeve për blerje mallra të natyrave të ndryshme, institucioni për këtë periudhë, i ka prokuruar dhe realizuar sipas nevojave konkrete, si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.

Realizimi i prokurimeve të shpenzimeve të akorduara për ILDKPKI, për vitin 2020 është mbështetur në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2020 dhe kërkesave konkrete të institucionit, të kërkesave për përmirësimin e mëtejshëm të punës në menaxhimin dhe zbatimin e objektivave të përcaktuara, duke zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni financiar, nëpërmjet një administrimi korrekt dhe kontrolli të vazhdueshëm.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Evgjeni BASHARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Nr. 3301/1 Prot

Data: 31.12.2020

Regjistri i realizimeve të prokurimit publik për periudhën (Janar - Dhjetor) 2020

Nr.Ref_1076001

Nr.	Objekti i Prokurimit	Kodet CPV	Fondi Limit	LLoji i Procedures se Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit te procedures se prokurimit	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	NIPT i Operatorit Ekonomik
1	Abonim në shtypin e shkruar për vitin 2020	Shërbime abonimi	206,000	Blerje e Vogël	204,800	27/01/2020	"Agjensia e Abonimit te Shtypit"	K31517010H
2	Blerje materiale Kancelari	Furnizime dhe pajisje të ndryshme zyre	666,667	Blerje e Vogël	629,100	24/01/2020	InfoSoft Office	J62426002Q
3	Blerje Materiale Pastrimi	Produkte pastrimi	416,667	Blerje e Vogël	315,000	24/01/2020	XH - N - SH GROUP	L92204011T
4	Sherbim per larjen e 3(tre)automjeteve te ILDKPKI	Shërbime larje makinash dhe të ngjashme	116,667	Blerje e Vogël	110,000	24/01/2020	Imer Ymeri	L01311010P
5	Sherbim mirembajtje ashensori	Shërbime të riparimit dhe mirëmbajtjes	125,000	Blerje e Vogël	82,500	14/02/2020	HYMERI KLEEMANN	K92309026B
6	Sherbim mirembajtje gjeneratori dhe stabilizatori	Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e gjeneratorëve	100,000	Blerje nen vleren 100 000 Leke	79,000	26/02/2020	EUROCOL SERVICE	J72111003K
7	Sherbim per sigurimin vjetor per 3(tre) automjetet e ILDKPKI	Sherbime per sigurimin e mjeteve motorrike	450,000	Blerje e Vogël	289,900	28/02/2020	INSIG SH.A	L71325019D
8	Sherbim per sigurimin vjetor per 3(tre) automjetet e ILDKPKI	Sherbime per sigurimin e mjeteve motorrike	160,000	Blerje e Vogël	119,000	3/7/2020	INSIG SH.A	L71325019D
9	Sherbim per sigurimin vjetor per 3(tre) automjetet e ILDKPKI	Sherbime per sigurimin e mjeteve motorrike	41,000	Blerje e Vogël	35,947	18/11/2020	INSIG SH.A	L71325019D
10	Sherbime te tjera	Shërbime të tjera	83,333	Blerje nen vleren 100 000 Leke	7,500	28/02/2020	Ermal Logu	L41308016G

11	Shërbime dezinfektimi i ambienteve të punës	Sherbime të pastrimit	100,000	Blerje nen vleren 100 000 Leke	95,500	22/06/2020	Pastrime Silvio	K91413010N
12	Ekzaminim i plotë i ashensorit të ILDKPKI sipas VKM nr. 1056 datë 23.12.2015	Shërbime të tjera	27,000	Blerje nen vleren 100 000 Leke	24,000	29/06/2020	SWISS APPROVAL ALBANIA (FRANCHISE SWISS APPROVAL) SHPK	K92025008F
13	Blerja e materialeve të nevojshme për mbrojtjen personale për përballimin e situatës të krijuar nga epidemia COVID-19	Produkte te kujdesit personal, Higjenzues për duart	66,667	Blerje nen vleren 100 000 Leke	55,417	30/06/2020	Sabri Skenderi	L02213021Q
14	Sherbim, riparim dhe mirembajtje e kondicionereve te ILDKPKI	Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi	100,000	Blerje nen vleren 100 000 Leke	95,000	6/7/2020	Dritan Xhaferri	K41605005H
15	Sherbim riparim/ mirembajtje per 3 automjetet e ILDKPKI	Shërbime mirëmbajtje makinash	500,000	Blerje e Vogël	443,650	10/7/2020	SERVIS - AUTO 2000	K31523078F
16	Blerje pajisje Elektronike	Pajisje elektronike	1,166,667	Kërkesë për propozim	1,059,600	20/07/2020	BNT ELECTRONICS	J61817047D
17	Blerje Karburant	Karburante	666,667	Blerje e Vogël	560,029	30/07/2020	"GEGA CENTER GKG"	K66801001T
18	Blerje UPS	Bateri	83,333	Blerje nen vleren 100 000 Leke	81,000	28/07/2020	ATOM	L22203042N
19	Mirëmbajtje dhe sherbime software (sistemi HIDAACI)	Mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacionit	66,666,667	Procedurë e hapur	64,666,670	2/9/2020	ikubINFO & Infosoft Systems	L11712002T
20	Orendi Zyre të Blera	Dollapë dhe raftet librash	500,000	Blerje e Vogël	396,000	16/10/2020	XHEZMI SIQECA	L86509203M
21	Regjistër elektronik për të drejtën e informimit	Shërbime elektronike te informacionit	100,000	Blerje nen vleren 100 000 Leke	72,000	22/10/2020	Smart Processes	L62119008A
22	Mirëmbajtje dhe azhornim të programit financiar Alpha Web Buxhetor	Shërbimet e lidhura me softwaret	100,000	Blerje nen vleren 100 000 Leke	98,206	22/10/2020	Instituti i Modelimeve ne Biznes	K01410001N
23	Sherbim larje fasade per ndertesën e ILDKPKI	Sherbime të pastrimit për ndërtesat	83,333	Blerje nen vleren 100 000 Leke	83,000	19/11/2020	Pastrime Silvio	K91413010N
24	Shërbim mbushje dhe kolaudim fikëse zjarri	Shërbime të tjera	25,000	Blerje nen vleren 100 000 Leke	25,000	19/11/2020	Vjollca Logu	L71406037B
25	Sherbim mirembajtje / riparime hidraulike	Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi	100,000	Blerje nen vleren 100 000 Leke	98,400	11/12/2020	XHEZMI SIQECA	L86509203M
26	Shërbim mirembajtje dhe riparime te vogla ndertese	Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi	100,000	Blerje nen vleren 100 000 Leke	98,500	6/11/2020	METAL- KONSTRUKSION VATA	K58427301U

27	Sherbim per sigurimin e ndërtesës të ILDKPKI	Shërbimet e sigurimeve	300,000	Blerje nen vleren 100 000 Leke	298,400	18/11/2020	INSIG SH.A	L71325019D
28	Lyerje të ambienteve të brendshme të godinës të ILDKPKI	Lyerje ndërtesash	100,000	Blerje nen vleren 100 000 Leke	99,330	24/11/2020	XHEZMI SIQECA	L86509203M
29	Sherbime mirembajtje dhe riparime te pajisjeve teknike te zyrave	Shërbime të ndryshme për riparim dhe mirëmbajtje	166,667	Blerje e Vogël	123,000	25/11/2020	ADASTRA	L41826018M
30	Blerje Materiale elektrike	Materiale elektrike	100,000	Blerje nen vleren 100 000 Leke	82,125	15/12/2020	NATASHA BREGASI	K71616014S
31	Blerje tonera per printera dhe fotokopje	Toner për makinat fotokopjuese	1,250,000	Kërkesë për propozim	841,917	24/11/2020	InfoSoft Office	J62426002Q

NJËSIA E PROKURIMIT

Arbër BASHOLLI

Ardita KRAJA

Erisa HAJDARI

NËPUNËSI ZBATUES

Miranda PORJA

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Evgjeni BASHARI